

TESS | TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL

**2025
2026**

**GUIDA E
STUDENTIT**

**VITI AKADEMIK: 2025-2026
TIRANË, SHQIPËRI**

MIRËSEERDHËT NË TESS

Mirë se vini në Kolegjin Profesional të Lartë TESS! Guida Studentore është shoqëruesja juaj gjatë gjithë studimeve: këtu do të gjeni informacionin thelbësor mbi programet tona, mënyrën si mësohet dhe vlerësohet në TESS, shërbimet e studentëve, bursat, rregullat e sjelljes dhe procedurat kryesore akademike.

SI TA PËRDORNI GUIDËN?

1. Filloni me **“Çfarë është TESS”** dhe **“Programet e studimit”** për një panoramë të plotë.
2. Shikoni **“Si mësohet në TESS”** dhe **“Vlerësimi në TESS”** për mënyrat e mësimdhënies/praktikës dhe kriteret e vlerësimit me notë.
3. Vizitoni **“Mbështetje për Studentët”** dhe **“Bursat”** për orientim, karrierë dhe ndihmë financiare.
4. Konsultoni **“Mirësjellje dhe Etikë”** dhe **“Ankesat/Apelimi”** për standardet dhe procedurat.



Për çdo paqartësi, Sekretaria Mësimore dhe Këshilltarët Akademikë janë në dispozicionin tuaj.

ÇFARË ËSHTË TESS?

TESS është Kolegji Profesional i Lartë i fokusuar në estetikë, parukeri dhe make-up, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 483, datë 31.07.2018. Misioni ynë është ta bëjmë estetikën pjesë të jetës së përditshme, duke formuar profesionistë me përgatitje të plotë teorike e praktike. Në bashkëpunim me markat ndërkombëtare **MAKE UP FOR EVER**, **Davines** dhe **Comfort Zone**, si edhe me staf të specializuar në make up, estetikë, parukeri, dermatologji, psikologji, ligj, menaxhim, marketing, art, fotografi dhe sociologji. TESS u jep studentëve njohuritë dhe aftësitë që kërkon industria.

Struktura akademike përbëhet nga dy departamente:

- **Departamenti i Estetikë-Nutricionit**
- **Departamenti i Kozmetologjisë**

CILAT PROGRAME STUDIMI OFRON TESS?

TESS ofron programe profesionale pas përfundimit të shkollës së mesme të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) - Nivelit V të licencuara nga Ministria e Arsimit (MAS) dhe të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Programet zgjasin 1 dhe 2 vite akademike dhe përfundojnë me Diplomë Profesionale me 60 dhe 120 kredite (ECTS).

Programi i studimit Estetikë (2 vite, 1500 orë / 4 semestra).

Program 2-vjeçar që formon estetistë me profil "360°": bazë teorike e mbështetur në literaturë shkencore, demonstrime dhe praktikë laboratorike në protokollet e kujdesit të lëkurës, higjienë dhe përdorim aparaturash bazë; theks te kompetencat teknike dhe etika profesionale.

Programi i studimit Hair Artist (2 vite, 1500 orë / 4 semestra).

Program 2-vjeçar për zhvillimin e aftësive profesionale në prerje, lyerje dhe stilim të flokëve, me bazë në anatomi dhe trikologji, si edhe kompetenca komunikimi dhe menaxhimi pune; përfshin demonstrime dhe praktikë të udhëzuar në studio.

Programi i studimit Make Up Artist (1 vit, 750 orë / 2 semestra).

Program 1-vjeçar që zhvillon aftësi krijuese dhe standarde profesionale për make-up mode, bridal, eventesh, TV/film dhe editorial; kombinon leksione, demonstrime, praktikë një-më-një dhe projekte individuale të portofolit.

Diploma dhe kredite. Në përfundim të programeve Estetikë, Hair Artist dhe Make-Up Artist, lëshohet **Diplomë Profesionale (Niveli V, 60/120 ECTS)** sipas kuadrit ligjor të MAS/ASCAL, pas përmbushjes së plotë të kurrikulës dhe provimit përfundimtar (kur aplikohet).

Transferimi i krediteve / RPL. TESS zbaton transferimin e krediteve dhe njohjen e të nxënit të mëparshëm (RPL) sipas udhëzimeve/rregullores; procedurat, dokumentet dhe afatet publikohen në faqen zyrtare.

Baza ligjore dhe akreditimi. Kolegji Profesional i Lartë TESS është hapur me **VKM nr. 483, datë 31.07.2018.** Institucioni dhe Programet e Studimit janë të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë - **ASCAL**; partneritetet akademiko-profesionale (p.sh. MAKE UP FOR EVER, Davines, Comfort Zone) integrohen në kurrikula dhe burime mësimore.

KARRIERA PAS TESS



Estetist/e. Punësim në SPA/sallone, klinika estetike, si instruktor/e trajnimesh ose përfaqësues/e produkteve. Shërbime: trajtime fytyre e trupi, higjienë dhe kujdes i lëkurës, konsulentë bazë dermatologjike (jo klinike). Kërkon komunikim të mirë, teknika të sakta dhe etikë profesionale.

Hair Artist. Punësim në sallone, SPA, hotele/resorte, industri mode/TV; mundësi sipërmarrjeje (hapje salloni). Kompetenca: prerje, krehje, lyerje bazë dhe të avancuara, trajtime, stilime; menaxhim klientësh, marketing personal dhe punë në ekip.

Make Up Artist. Punësim në evente (dasma, fashion, editorial), TV/film/teatër, foto/produksione komerciale; bashkëpunim me fotografë/stiliste. Fusha kreative përfshin edhe efekte speciale (SFX) dhe HD/Studio make-up.

Aftësi të përbashkëta për sukses: shërbim cilësor ndaj klientit, kreativitet, portofol profesional, menaxhim kohe, higjienë dhe siguri, komunikim i qartë dhe vëmendje ndaj detajeve. Tregu është në rritje dhe favorizon profilin praktik dhe portofolin e punës.

PRANIMI DHE REGJISTRIMI



TESS pranon kandidatë të rritur (mosha ≥ 18 vjeç) që kanë përfunduar arsimin e mesëm, pajisur me Diplomë të Maturës Shtetërore dhe tregojnë interes të qartë, si edhe njohuri bazë në fushat e estetikës, parukerisë ose make up-it. Vlerësimi i përshtatshmërisë bëhet mbi bazën e dokumentacionit arsimor dhe, kur është e nevojshme, një bisedë orientuese me personelin akademik për të përcaktuar programin më të përshtatshëm.

Si të regjistroheni?

Maturantët që kanë plotësuar formularin A1/A1Z regjistrohen përmes platformës U-Albania, duke ndjekur afatet zyrtare. Kandidatët e tjerë (p.sh. të diplomuar më herët) kontaktojnë Sekretarinë e TESS për udhëzime mbi procedurën, afatet dhe kuotat.

Dokumentet që dorëzohen në momentin e regjistrimit.

Kopje të dokumentit të identifikimit (ID/Pass), kopje të noterizuara të diplomës së gjimnazit dhe certifikatës së notave (ose të diplomës së parë universitare, nëse aplikohet), si dhe mandat-pagesën e tarifës së shkollës sipas udhëzimit financiar.

Dokumentet verifikohen nga Sekretaria Mësimore dhe ruhen sipas politikave të mbrojtjes së të dhënave.

Pas verifikimit, kandidati regjistrohet në programin e zgjedhur dhe informohet me shkrim për kalendarin akademik, orarin orientues dhe aksesin në Guidën e Studentit, syllabuset dhe arkivin elektronik. Nëse programi parashikon kërkesa specifike (p.sh. kit bazë laboratorik), kandidati merr listën përkatëse dhe afatet e pajisjes.

SI MËSOHET NË TESS?

Në TESS mësimi ndërtohet mbi kombinimin e leksioneve, seminareve dhe laboratorit/studios, në mënyrë që njohuritë teorike të kthehen menjëherë në aftësi praktike. Leksionet vendosin bazën (anatomi/trikologji, higjienë e siguri, teori ngjyrash, produkte e protokolle), seminarët thellojnë me raste studimore dhe analiza vizuale, ndërsa laboratorit/studio fokusohet në demonstrime “hap-pas-hapi” dhe ushtrime 1-më-1, me simulime reale shërbimi.

Procesi plotësohet me praktika dhe demonstrime nga partnerët tanë (MAKE UP FOR EVER, Davines, Comfort Zone), si dhe projekte individuale që dokumentohen në portofolin personal (koncept, realizim, foto para/pas, reflektim). Çdo student mbështetet nga këshilltarë akademikë dhe mentorë industrie që ofrojnë udhëzim për planin e të nxënit, etikën e shërbimit, komunikimin me klientin dhe standardet profesionale.

Burimet mësimore përfshijnë bibliotekën fizike dhe arkivin elektronik me manuale profesionale, video-trajnime dhe protokollat zyrtarë të markave partnere. Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe kombinon pjesëmarrjen/angazhimin dhe detyrat në studio me projektet/portofolin dhe provimin përfundimtar; peshët saktësohen në syllabus të çdo lënde. Pritet pjesëmarrje aktive, portofol i përditësuar dhe respekt i rreptë i protokolleve të higjienës/sigurisë. TESS ofron orë konsultimi, workshop-e “skills booster” dhe mbështetje karriere (praktika, simulime interviste, CV/portfolio).

VLERËSIMI NË TESS?

Vlerësimi në TESS kombinon kontrollin e vazhdueshëm gjatë semestrit me provimin përfundimtar. Për çdo lëndë, nota finale ndërtohet nga: aktiviteti/angazhimi dhe prezenca, vlerësimet e ndërmjetme (teste/detyra/projekte/praktikë) dhe provimi final. Peshët e sakta përcaktohen në programin individual të çdo lënde (syllabus) nga titullari i lëndës dhe miratohen nga departamenti.

Formatet e vlerësimit: Përdoren teste me shkrim (60-180 min, përfshirë alternativa), seminare ose praktikë, detyra kursi, demonstrime dhe vlerësim i praktikës profesionale. Testet vlerësohen me sistem pikësh që konvertohet në notë. Notat jepen në shkallën 1-10; 5-10 janë kaluese. Konvertimi nga pikë në notë ndiqet sipas tabelës institucionale (p.sh. ≤ 50 pikë = 4; 90-100 = 10).

E drejta për të hyrë në provim: Studenti duhet të ketë:

- përmbushur detyrimet e lëndës (detyrat/projektet),
- shlyer detyrimet financiare,
- kryer regjistrimin në sezon/datën përkatëse,
- respektuar kufijtë e mungesave kur frekuentimi është i detyrueshëm.

Për studio/praktika kërkohet mbrojtja 100% e detyrimeve praktike/laboratorike. Pjesëmarrja minimale e detyrueshme: $\geq 75\%$ në leksione/seminare.

Sezonet, riprovimet dhe përmirësimet: Sezoni i dimrit zhvillohet pas semestrit I, sezoni i verës pas semestrit II, ndërsa sezoni i vjeshtës në shtator. Struktura Akadematike miratohet dhe shpallet në fillim të vitit. Lejohen provime të mbartura dhe përmirësimi i maksimumi 3 lëndëve (procedurat i publikon Sekretaria). Në rast regjistrimi të përsëritur dhe moskalimi/mungese në provim, mund të lindin detyrime financiare për kreditet e mbetura, sipas vendimeve në fuqi. Rastet shëndetësore të provuara rishikohen me ridizenjim të planit të studimeve.

Transparenca dhe komunikimi i notave: Kriteret, peshët dhe format e vlerësimit publikohen në syllabus dhe shpjegohen në

orën e parë të fillimit të çdo lënde. Notat komunikohen nga Sekretaria Mësimore brenda afateve dhe shoqërohen me dokumentimin përkatës (procesverbale/regjistra).

Rishikimi/ankimimi i notës: Studenti mund të kërkojë sqarim dhe rishikim brenda afatit, me kërkesë të arsyetuar me shkrim. Rishikimi zhvillohet në dy shkallë: (1) nga titullari/komisioni i lëndës mbi bazën e provave; (2) nga një komision i posaçëm në nivel departamenti/IA, që verifikon përputhjen me syllabusin dhe rregullat dhe jep vendim të arsyetuar. Çdo ndryshim note dokumentohet.

Praktika profesionale dhe diplomimi: Praktika është detyrim programor; në fund dorëzohet relacion pune që vlerësohet nga pedagogu (me mendimin e qendrës pritëse). Diploma profesionale jepet pasi studenti ka përfunduar të gjitha detyrimet dhe ka kaluar me sukses provimin përfundimtar; udhëzimet e provimeve të formimit bëhen të ditura në fillim të vitit akademik.

MBËSHËTETJE PËR STUDENTËT

TESS ofron **këshillim akademik dhe mentorim**: këshilltarët ndihmojnë në hartimin e planit personal të të nxënit, ndjekjen e progresit dhe kalimet e mundshme të programit, me konsultime periodike dhe udhëzim për portofolin profesional.

Për **aktivitetet dhe karrierën**, institucioni vë në dispozicion hapësira/logjistikë për klube e workshop-e, si dhe njoftime të rregullta për praktika, “career days”, simulime intervistash dhe këshillim për CV/portfolio në bashkëpunim me partnerët e industrisë.

Studentët me nevoja të veçanta përfitojnë përshtatje të arsyeshme (orare të zgjatura, lehtësira praktike dhe alternativa vlerësimi kur lejon natyra e kompetencës), mbi bazën e kërkesës zyrtare dhe dokumentimit, duke respektuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave. Njoftimet dhe aksesimi i shërbimeve bëhen përmes Sekretarisë, email-it institucional dhe Guida-s së Studentit.

Përfaqësimi studentor: Këshilli Studentor përfaqëson interesat e studentëve në TESS dhe merr pjesë me të drejtë propozimi/konsultimi në komisione dhe organet kolegjiale sipas rregullores. Zgjedhjet zhvillohen çdo vit akademik; të gjithë studentët mund të kandidojnë dhe të paraqesin nisma për jetën akademike e shërbimet.

BURSA STUDIMI

TESS shpall çdo vit bursat me afate dhe kritere të qarta, me aplikim. Skemat përfshijnë bursa merite/talenti, sociale (PAK, status jetim, ndihmë ekonomike, pakica), prioriteti strategjik (programe kyçe) dhe raste të veçanta (emergjenca të dokumentuara). Procedura ndjek këto hapa: aplikim me dokumente verifikim formal nga Sekretaria vlerësim me pikëzim nga komisioni vendim i arsyetuar me të drejtë ankimi brenda afatit. Rezultatet publikohen duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale.

MIRË- SJELLJE DHE ETIKË

TESS kërkon sjellje të respektueshme dhe profesionale në të gjitha ambientet dhe aktivitetet akademike. Kodi i Etikës përfshin: integritet akademik, respekt ndaj stafit e studentëve, mjedis pa diskriminim/ngacmim, ruajtje të pasurisë dhe zbatim të protokolleve të higjienës e sigurisë. Shkeljet mund të sjellin masa disiplinore sipas rregulloreve.

Çdo student ka të drejtë të parashtojë ankesë të arsyetuar me shkrim (p.sh. për vlerësim, sjellje, shërbime). Hapat:

- 1. Dorëzimi** te Sekretaria/zyra përgjegjëse brenda afatit të publikuar;
- 2. Regjistrim & njoftim** i marrjes;
- 3. Verifikim** nga titullari/komisioni i lëndës ose struktura përgjegjëse;
- 4. Vendim i arsyetuar me shkrim** dhe afat për **apel**;
- 5. Apeli** në nivel Departamenti/Komision Etike/NJBSC, sipas natyrës së çështjes.

Udhëzimet e plota dhe afatet janë të publikuara në njoftimet zyrtare të TESS.

TESS përpunon të dhënat personale sipas Politikës së Privatësisë dhe legjislacionit në fuqi, duke siguruar ruajtje të sigurt dhe përdorim vetëm për qëllime akademike e administrative.



TESS

TESS | TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL

JU MUND TË NA KONTAKTONI NË:

WEB: WWW.TESS.AL

EMAIL: INFO@TESS.AL

FACEBOOK: TESS – TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL

INSTAGRAM: @TESS.ALBANIA

LINKEDIN: TESS – TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL

CEL: +355694000014 / +355694000113

KU NDOHET SHKOLLA?

RRUGA "GJENERAL NIKOLS" PALLATI SHUSHICA, KATI I
PARË, TIRANË, SHQIPËRI.

**SI MUND TË
KONTAKTOJMË
PËR MË SHUMË
INFORMACIONE?**